



Provimet Keystone të Pensilvanisë

Çfarë janë Provimet Keystone?

Provimet Keystone janë vlerësime në fund të kursit mësimor të bazuara në standarde për të vlerësuar aftësimin në Algjebrën I, Letërsi dhe Biologji. Ato kanë rëndësi të madhe në [kërkesat e mbarë shtetit të Pensilvanisë për diplomimin në shkollën e mesme](#).

Kur do t'i bëjë Provimet Keystone fëmija im?

Keystone zhvillohet nga shkollat SDP gjatë sezonit të dimrit (janar) dhe gjatë sezonit të pranverës (maj). Studentët që bëjnë provimet Keystone për herë të parë, zakonisht ulen për vlerësimin gjatë sezonit të pranverës teksa i afrohen përfundimit të kursit ose kurseve të Algjebrës I, Anglishtes 2 dhe/ose Biologjisë. Zakonisht sezoni i dimrit është për studentët që i përsëritin provimet Keystone nëse nuk kanë arritur rezultat të kënaqshëm herën e parë. Gjithashtu studentët mund t'i përsëritin provimet Keystone gjatë sezonit të pranverës. Kalendarin për sezonet e provimeve Keystone mund të gjendet [këtu](#). Gjithashtu duhet të shikoni [Kalendarin e SDP për Vlerësimet](#), si edhe kalendarin e shkollës të fëmijës suaj për datat e caktuara të zhvillimit të provimeve Keystone.

Çfarë bëjnë mësuesit me rezultatet e provimeve Keystone të fëmijës tim?

Rezultatet individuale të studentëve, të cilat i jepen vetëm shkollës të fëmijës tuaj, mund të përdoren për të ndihmuar mësuesit të dallojnë cilat janë pikat e forta dhe të dobëta të fëmijës suaj. Kjo më pas u jep mundësi mësuesve ta përshtatin mësimdhënien për fëmijën tuaj në mënyrë që ta ndihmojnë të zhvillohet më tej. Përveç kësaj, meqenëse provimet Keystone janë një komponent i rëndësishëm i kërkesave të mbarë shtetit të Pensilvanisë për diplomimin për shkollën e mesme, shkollat do t'i përdorin këto rezultate për të kuptuar se në cilat fusha kanë nevojë për mësim të mëtejshëm studentët që po planifikojnë të përsëritin provimin, në mënyrë që të përgatiten për të arritur rezultat më të mirë herën e dytë. Rezultatet Keystone u japin gjithashtu informacion të rëndësishëm shkollave dhe rretheve shkollore, të cilat ndihmojnë për të diskutuar për përmirësimin dhe planifikimin lidhur me planin mësimor dhe mësimdhënien.

Çfarë lloj pyetjesh bëhen në provimet Keystone?

Për të tria provimet Keystone, studentët duhet t'u përgjigjen një sërë pyetjesh me alternativa dhe pyetjeve me përgjigje të formuluar. Përgjigjet e formuluar paraqiten me shkrim dhe vlerësohen duke përdorur një rubrikë. Për më shumë informacion lidhur me këtë temë, ju lutemi të shikoni dokumentet e projektimit të testit të [Letërsisë](#), [Algjebrës 1](#) dhe [Biologjisë](#).

Cilat lloje rezultatesh raportohen në provimet Keystone?

Për të tria lëndët e testuara, studentët marrin një rezultat të përgjithshëm, një rezultat shkalle , dhe një vlerësim performance (Nën bazë, Bazë, I aftë, ose I avancuar) i cili lidhet me një rreze specifike të rezulttit të shkallës. Rezultati i shkallë që lidhet me secilin nivel performance ndryshon sipas lëndës. Për një ndarje më të hollësishme, mund të shikoni [tabelën e rezultateve të shkallës](#) të Departamentit të Arsimit të Pensilvanisë.

Përveç kësaj, Departamenti i Arsimit i Pensilvanisë u jep shkollave raporte për performancën individuale të studentëve sipas modulit. Secili provim Keystone përbëhet nga dy module.

Çfarë do të thotë “Nën bazë”, “Bazë”, “I aftë” ose “I avancuar”?

Departamenti i Arsimit i Pensilvanisë ka [përshkrues të nivelit të performancës](#) për Algjebrën 1, Letërsinë dhe Biologjinë.

Për provimin **Keystone të Letërsisë**, dy modulet janë (1) Letërsia Artistike dhe (2) Letërsia Joartistike. Për provimin **Keystone të Algjebrës 1**, dy modulet janë (1) Operacionet dhe Ekuacionet Lineare & Pabarazitë dhe (2) Funkcionet Lineare & Organizimi i të dhënave. Për provimin **Keystone të Biologjisë**, dy modulet janë (1) Qelizat & Proceset Qelizore dhe (2) Vazhdimësia dhe Uniteti i Jetës.

A janë me kohë provimet Keystone?

Provimet Keystone nuk është me kohë, megjithatë studentët nuk mund ta plotësojnë një modul në më shumë se një ditë. Nëse një student e fillon një modul të hënën, ai nuk mund ta përfundojë atë seksion të martën. Departamenti i Arsimit i Pensilvanisë siguron një kohë të përlogaritur të kryerjes së testit për secilin provim Keystone. Për Biologjinë, të dy modulet zgjatin rreth 72 minuta secili. Për letërsinë, të dy modulet zgjatin rreth 73 minuta secili. Për Algjebrën 1, të dy modulet zgjatin rreth 75 minuta për t’u përfunduar. Megjithatë, studentët nuk janë të detyruar ta përfundojnë provimin brenda këtij afati; atyre u jepet kohë shtesë sipas nevojës për ta përfunduar provimin.

A ndikojnë provimet Keystone te notat e fëmijës tim?

Ky test nuk ndikon te notat e studentëve. Megjithatë, ato kanë rëndësi të madhe në [kërkesat e mbarë shtetit të Pensilvanisë për diplomimin në shkollën e mesme](#).

Si i bën provimet Keystone fëmija im?

Provimet Keystone zakonisht bëhet me laps dhe letër; megjithatë ka edhe versione online të testit. Pavarësisht nga versioni që zgjedh fëmija juaj, të gjithë studentët duhet të jenë të pranishëm fizikisht në shkollë për provimet Keystone.

Ku mund t'i gjej rezultatet e provimeve Keystone?

Shkollat marrin dy kopje në letër të raporteve individuale të studentit pak muaj pasi përfundon testimi. Mund t'i kërkonit shkollës së fëmijës suaj një kopje të shtypur të Raportit të Studentit.

Rezultatet postohen gjithashtu në një Portal për Prindërit te pjesa Testi Standard te Profili i Studentit.

Kë mund të kontaktoj nëse kam pyetje të mëtejshme për provimet Keystone?

Nëse keni pyetje të mëtejshme për provimet Keystone, rekomandojmë që të kontaktoni shkollën e fëmijës tuaj. Informacionet e kontaktit për shkollën e fëmijës suaj mund të merren nga [faqja e internetit e Profileve të Shkollës](#) e SDP.

Ku mund të gjej më shumë informacion për provimet Keystone?

Zyra e Vlerësimeve e Rrethit Shkollor të Filadelfias:
<https://www.philasd.org/research/#assessmentsera>

Faqja e internetit për provimet Keystone e Departamentit të Arsimit të Pensilvanisë:

<https://www.education.pa.gov/K-12/Assessment%20and%20Accountability/Keystones/Pages/default.aspx>